

## **MIMOZA LLOJI**



Kryeaudituese në KLSH, Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Lindur në 1960. Diplomuar në Agronomi(1984). 36 vite eksperiencë pune.

8 vitet e fundit si audituese në KLSH. Kryeaudituese nga viti 2009.

Fusha e ekspertizës: Auditimi i ruajtjes së mjedisit.

## **ROLI I KLSH NË PËRMIRËSIMIN E SITUATËS MJEDISORE<sup>i</sup>**

nga *Mimoza Lloji*

Kontrolli i Lartë i Shtetit(KLSH), në veprimtarinë e saj krahas auditiveve financiare, të ligjshmërisë, rregullshmërisë apo tematik, kryen dhe auditime në fushën mjedisore.

Auditimet në fushën mjedisore janë ushtruar në institucionet shtetërore dhe agjencitë zbatuese të legjislacionit në këtë fushë, me objekt auditimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së këtyre organeve me legjislacionin e mjedisit, me qëllim që këto subjekte të ushtrojnë kompetencat dhe detyrimet ligjore në drejtim të mbrojtjes së mjedisit nga ndotjet dhe dëmtimet.

Auditimet janë ushtruar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si institucioni kryesor përgjegjës, në agjencitë në vartësi të saj si Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, Tiranë, Agjencitë Rajonale të Mjedisit në Qarqe dhe Drejtoritë e Shërbimit Pyjor në rrethe, Auditime të performancës mjedisore në disa bashki, si Lezhë, Berat, Tiranë, Elbasan, Fier etj.,auditime të cilat janë kryer në lidhje me zbatimin e paketës ligjore në këtë fushë.

Nga auditimet e ushtruara është konstatuar se problemet e mbrojtjes së mjedisit kanë filluar të bëhen shqetësim për qytetarët, organizmat e ngarkuar me ligj, etj. Nga subjektet zbatuese në veçanti nga ato të pushtetit vendor konstatohet se tendenca për kujdesen dhe përmirësimin e mjedisit urban për arritjen e parametrave që ligji përcakton është me trend pozitiv, si në trajtimin mjedisor të mbetjeve urbane, shtimin e sipërfaqeve të gjelbëtra, përmirësimi i treguesve të ajrit urban dhe të tjerë tregues.

Gjatë auditiveve është konstatuar se paketa ligjore për mjedisin ka qënë jo e plotë me ekuivoke si pasoje dhe zbatimi i saj në praktikë ka qënë në shkallë të jo të pëlqyeshme.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ka punuar në vazhdimësi për ta kompletuar paketën ligjore për mbrojtjen e mjedisit me qëllim për ta përshtatur dhe për të realizuar përputhshmërinë e saj me standardet e legjislacionit të Bashkimit European.

Në këtë kuadër mund të përmendim ndryshimin apo përmirësimin e kuadrit ligjor: si ligji “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligji “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ligji “Për lejet mjedisore”, ligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, përmirësime ligjore në të cilat janë pasqyruar dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH.

Por krahas punës së bërë për përmirësimin dhe përshtatjen e paketës ligjore mbi mjedisin në auditime konstatohen të meta dhe mangësi në veprimtarinë e institucioneve përkatëse, është konstatuar se këto organizma nuk kanë vepruar në përputhje me legjislacionin për rrjedhoje dhe dëmtimi i mjedisit edhe pse është i pamatshëm është evident.

Në lidhje me zbatimin e strategjisë ndërsektorale për mbrojtjen e mjedisit është konstatuar mungesë koordinimi midis Ministrisë së Mjedisit, me

institucionet e tjera shtetërore që ligji i ngarkon për mbrojtjen e mjedisit në fushat përkatëse.

Mungesa e një sistemi evidencash ka bërë që të mos pasqyrohen në vazhdimësi arritjet dhe mangësitë në zbatimin e strategjisë mjedisore, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, si dokumenti bazë që parashtron politikat shtetërore në fushën e mjedisit.

Nga auditimet janë konstatuar se strukturat përkatëse për mbrojtjen e mjedisit në veprimtarinë e tyre kanë mospërputhje të veprimtarisë me legjislacionin e miratuar pasi strukturat përkatëse kanë treguar inkopetencë në drejtim të politikëbërjes për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi në shkallë rajonale si dhe të zbatimit të ligjshmërisë së mjedisit.

Për sa pasqyruam më lart vinë si pasojë e mungesës së standardeve në rekrutimin e personelit të ARM si dhe të Inspektoratit të Mjedisit, mungesa e trajtimit të specialistëve të fushës përkatëse.

Njëkohësisht vërehet mungesë mungesë koordinimi midis inspektoratit dhe organeve të pushtetit vendor si dhe organeve të tjera që legjislacioni specifik i ngarkon për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi në fushën e inspektimit dhe kontrollit të përbashkët në subjektet që kanë ndikim të lartë dhe të mesëm në mjedis.

Inkopenca profesionale pasqyrohet në procesin e dhënies së lejeve mjedisore, në kontrollin dhe monitorimin e subjekteve që gjenerojnë mbetje të ngurta, të lëngëta e të gazta etj. apo në dëmtimin e mjedisit gjatë përdorimit të tij.

Është konstatuar se legjislacioni mjedisor ka qenë me mangësi dhe i paplotësuar me akte nën ligjore, më e theksuar kjo për agjencitë zbatuese të legjislacionit mjedisor si Agjencitë Rajonale të Mjedisit, dhe Agjencia e

Mjedisit dhe Pyjeve, të cilat ende funksionojnë me legjislacion të pa plotësuar.

Drejtoritë e Shërbimit Pyjor ende funksionojnë në shkallë rrethi dhe jo në shkallë rajonale, në kundërshtim me ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor” me ndryshime.

Këto drejtori nuk e justifikojnë formën e organizimit të tyre me sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave të mbetura për administrim, si pasojë dhe efektiviteti dhe efienca e tyre është e dobët.

Transferimi i pyjeve dhe kullotave nga pronësia e shtetit në drejtim të Njësisve të Qeverisjes Vendore nuk është shoqëruar me kuadrin e plotë ligjor, gjë që ka bërë që situata mjedisore në pyje dhe kullotat komunale të mos njihet nga organet kompetente.

Komitetet e Menaxhimit për zonat e mbrojtura dhe administrata e tyre, janë organizma pa fuqi vendimmarrëse dhe ekzekutive, efienca dhe efektiviteti i tyre në drejtim të administrimit është tepër i ulët si rrjedhojë dhe gjendja dhe situata mjedisore në këto zona është në tendencë përkeqësimi.

Për këto arsye nga ana e KLSH i është rekomanduar MMPAU që të bëjë analizë të thelluar të situatës në pyje, kullota dhe zona të mbrojtura dhe mbi bazën e përfundimeve, të hartohen planet e veprimtari si dhe rishikimi i paketës ligjore, pasi kanë ndodhur ndryshime të mëdha në drejtim të pronësisë së fondit pyjor, kullotave dhe zonave të mbrojtura si dhe mbi këtë bazë të përcaktohen masat për përmirësimin e gjendjes së tyre.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në bazë të rekomandimeve të dhëna nga KLSH është në procesin e rishqyrtimit të akteve ligjore për zonat e mbrojtura, ku po përcaktohen qartësisht organet e vartësisë së këtyre zonave si dhe të drejtat dhe detyrimet që do të kenë këto struktura në drejtim të administrimit, menaxhimit, rruajtjes dhe rritjes së

vlerave që ato përmbajnë me qëllim që këto zona të plotësojnë objektivat për të cilat janë shpallur që të jenë sa më atraktive për qytetarët dhe turistët.

---

<sup>i</sup> Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 04 Shtator, 2013